

## Partnerët Shqipëri hap aplikimet për “Akademinë e OJF-ve 2017”

Akademia e OJF-ve vjen për të tretin vit radhazi, si një program i konsoliduar i cili ofron mundësi edukimi dhe zhvillimi nëpërmjet metodave më bashkëkohore të të mësuarit dhe përvojave shumëdimensionale të shkëmbimit të eksperiencave për drejtues të OJF-ve në të gjithë vendin.

Gjatë dy viteve të fundit, 42 drejtues organizatash jofitimprurëse përfituan njohuri dhe aftësi, mundësi bashkëpunimi, rrjetëzimi dhe partneriteti me organizata të ngjashme brënda dhe jashtë vendit. Nëpërmjet një programi vijues asistence dhe mentorimi, OJF-të pjesëmarrëse do të udhëhiqen drejt zbatimit efektiv të njohurive dhe aftësive të fituara në Akademi.

### Panoramë e Përgjithshme

Organizatave jofitimprurëse (OJF) në Shqipëri punojnë në një mjedis dinamik dhe luajnë një rol domethënës në zhvillimin e vendit përmes shtrirjes së veprimtarisë në shumë fusha si dhe aftësive të ndryshme që zotërojnë.

Në dy dekadat e fundit, sektori i OJF-ve në Shqipëri është rritur në numër (vetëm në vitin 2016, janë rregjistruar 307 OJF - prej të cilave 221 shoqata; 60 qendra dhe 26 fondacione); gjithashtu, kuadri ligjor dhe financiar që rregullon aktivitetin e OJF-ve ka qenë subjekt i ndryshimeve dhe amendimeve të cilat kanë ndikuar në qëndrueshmërinë dhe aktivitetin e organizatave jofitimprurëse si dhe në marrëdhëniet e tyre me shtetin. Nevoja për njohjen e tij nga ana e sektorit mbetet prioritet për të mundësuar një veprimtari eficiente.

Pjesëmarrja dhe përfshirja e OJF-ve në vendimmarrje në nivel qendror dhe vendor është e rëndësishme për të siguruar që ligjet, politikat dhe strategjitë i përgjigjen nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përfshirja dhe prezenca e sektorit në çështje publike ndër vite, ka marrë gjithnjë e më shumë visibilitet, por ka ende hapësira për përmirësim dhe aksione të koordinuara për një pjesëmarrje efektive të OJF-ve në proceset politikëbërëse e vendimmarrëse në vend, duke ndjekur standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

Roli i organizatave jo fitimprurëse si promotorë të ndryshimit, varet në maturinë, kompetencën, përgatitjen dhe kapacitetet për të bashkëpunuar me sukses me partnerë strategjikë në vend. Pavarësisht eksperiencës së fituar, OJF-të kanë ende nevojë për asistencë për arritjen e rezultateve thelbësore, sidhe OJF-të kanë ende nevojë të përmirësojnë aftësitë e tyre lidhur me zhvillimin dhe menaxhimin organizativ, qëndrueshmërinë dhe përfshirjen në procese pjesëmarrëse.

### Akademia e OJF-ve do të:

- Shërbejë si hapësirë e edukimit jo-formal për të përforcuar aftësitë dhe zhvilluar kompetencat e drejtuesve të OJF-ve;
- Rrisë profesionalizmin e këtyre drejtuesve nëpërmjet një kurrikule unike, metodave më bashkëkohore të të nxënimit si dhe përvojës profesionale shumëdimensionale;
- Krijojë breza drejtuesish profesionistë dhe të angazhuar, që do të jenë aktorë të ndryshimit dhe kontribues në zhvillimin e shoqërisë Shqiptare.

Akademia e OJF-ve do të zbatohet në periudhën shkurt - korrik 2017 dhe do të konsistojë në:

- seri leksionesh (do të prezantohen 10 tema gjatë 2-3 takimeve/muaj);
- përgatitjen dhe prezantimin e detyrave të ndryshme si: krijimi/ rishikimi i politikave dhe procedurave të brendshme, formateve të raportimit financiar, formateve të projekt propozimeve, planeve për sigurimin e fondeve, mjetet e komunikimit etj.
- pjesëmarrjen në një vizitë studimore në Sllovaki - prezantim me veprimtarinë e OJFve sllovaqe, modele të bashkëpunimit OJF-shtet, aksionet inovative në luftën kundër korrupsionit, procese me pjesëmarrje, crowd sourcing, rritje fondesh etj.

*Akademia e OJF-ve zbatohet nga Partnerët Shqipëri në bashkëpunim me Partnerët për Ndryshim Demokratik Sllovaki (PDCS) në kuadër të projektit “Shtyllat e shoqërisë civile: Bashkëpunim më efektiv ndërmjet sektorit të shoqërisë civile dhe shtetit në Shqipëri”, financuar nga Slovak Aid – Asistenca Zyrtares për Zhvillim e Republikës së Sllovakisë.*

## Aplikimi

Akademia është e hapur për drejtues të OJF-ve shqiptare në pozicionet: Drejtor Ekzekutiv, Manaxher Programi dhe Kryetar Bordi/Kryesia, të cilët synojnë rritjen e aftësive dhe zhvillimin e tyre profesional në këtë sektor për të ndërtuar organizata efektive në shërbim të publikut dhe grupeve të interesit.

Kandidatët e interesuar për Akademinë e OJF-ve 2017 janë të ftuar të aplikojnë duke plotësuar [Formën e Aplikimit](#). Afati i fundit për dorëzimin e formës së aplikimit është **3 shkurt 2017 ora 17.00**

## Kriteret dhe procesi i përzgjedhjes!

Akademia do të mundësojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorit me një shpërndarje të gjerë gjeografike dhe përfaqësim divers nësektorial.

**16 pjesëmarrës** do të përzgjidhen për Akademinë e OJF-ve, 2017.

Një pjesë e programit planifikohet të jetë në gjuhën Angleze. Përdorimi i literaturës, rasteve studimore dhe pjesëmarrja në vizitën studimore do të kërkojnë nivel të mirë njohjeje dhe përdorimi të gjuhës angleze.

### Kriteret

Kandidatët do të përzgjidhen bazuar në:

- Motivimin për ndjekjen e Akademisë.
- Lidhjen ndërmjet rritjes individuale profesionale dhe zhvillimit të organizatës që drejton
- Angazhimin për të ndjekur të plotë programin e Akademisë dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve si pjesë e tij.
- Njohjen dhe përdorimin e gjuhës Angleze.

### Procesi

- Të gjithë të interesuarit duhet të plotësojnë dhe dorëzojnë brenda datës 3 shkurt 2017 formën e aplikimit.
- Kandidatet e përzgjedhur do të njoftohen brenda datës 10 shkurt 2017. Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen.
- Kandidatët e përzgjedhur do të vlerësohen mbi nivelin e njohjes së gjuhës angleze (intervistë në telefon) para konfirmimit si pjesëmarrës në Akademi.

## Programi

Periudha	Sesionet
Shkurt	1. Hapja e Akademisë - Tendencat e zhvillimit të sektorit të shoqërisë civile dhe kuadri ligjor për sektorin e OJF-ve.
Mars	2. Zhvillimi organizativ dhe qeverisja organizative. Manaxhimi i burimeve njerëzore dhe procedurat e brendshme. 3. Manaxhimi financiar: Buxheti dhe kontabiliteti; Detyrimet dhe raportimet në shtet. 4. Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin privat. Ngritja e fondeve dhe filantropia.
Prill	5. Sigurimi i mbështetjes financiare përmes granteve. Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve, grantet e BE-së. 6. Komunikimi strategjik i OJF-ve.
Maj	7. Planifikimi strategjik. 8. Qeverisja me pjesëmarrje.
Qershor	9. Mobilizimi i mbështetësve. Krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve. 10. Advokasia dhe lobimi. * Vizitë studimore në Sllovaki.
Korrik	Ceremonia e diplomimit.

Për më tepër informacion, luteni të kontaktoni  
Znj. Jonida Alite, Drejtore e Trainimit, në [jalite@partnersalbania.org](mailto:jalite@partnersalbania.org)

Shënim: POLITIKA JODISKRIMINUESE E PRANIMEVE NE AKADEMI  
Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve Partnerët Shqiptari do të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit  
mbi baza gjinore, fetare, etnie apo orientimi seksual.